



UK Health
Security
Agency



Mbroni veten nga gripi

Vaksinimi kundër gripit në Angli

Informacion për ata në shkollë të mesme



Flu **i**mmunisation

Ndihmon për t'ju mbrojtur kundër gripit

Vaksina e gripit ofrohet falas për:

Të gjithë fëmijët
2 dhe 3 vjeç
(me kusht që të kenë
qenë 2 ose 3 vjeç më
31 gusht përpara se
të fillojë vaksinimi i
gripit në vjeshtë).



Fëmijët e moshës
shkollore
(nga kopshti
deri në klasën e
11-të).

Fëmijët nga
mosha 6 muajshe
me një gjendje
shëndetësore që i
vë në rrezik më të
madh nga gripi.



Informacione të mëtejshme se cilët fëmijë
kualifikohen çdo vit mund të gjenden në:
www.nhs.uk/child-flu

Pse duhet ta bëj vaksinën e gripit?

Gripi mund të jetë një sëmundje shumë e pakëndshme që shkakton ethe, lodhje ekstreme, dhimbje të muskujve dhe nyjeve, hundë të mbyllura, kollë të thatë dhe dhimbje fyti. Zakonisht filloni të ndiheni më mirë brenda rreth një jave. Disa persona zhvillojnë komplikime dhe duhet të shkojnë në spital për trajtim.

Cilat janë përfitimet e vaksinës?

Bërja e vaksinës do t'ju ndihmojë të mbroheni nga ajo që mund të jetë një sëmundje shumë e keqe. Mund t'ju ndihmojë të shmangni nevojën për të humbur gjërat që ju pëlqejnë dhe ndërprerje në arsimin tuaj.

Vaksina gjithashtu zvogëlon mundësinë që ju të përhapni gripin te të tjerët, kështu që nga ana tjetër ndihmon në mbrojtjen e familjes dhe miqve tuaj.

Unë e bëra vaksinën kundër gripit vitin e kaluar.

A kam nevojë për një tjetër këtë vit?

Po. Viruset e gripit ndryshojnë çdo vit, kështu që vakcina mund të përditësohet. Për këtë arsye ju rekomandojmë që edhe këtë vit të vaksinoheni kundër gripit, edhe nëse jeni vaksinuar vitin e kaluar.



Si do të jepet vaksina?

Zakonisht jepet si spërkatje në hundë. Nëse spërkatja në hundë nuk është e përshtatshme, mund të bëhet një injeksion, zakonisht në muskulin e krahut të sipërm.

Pra, si funksionon spërkatja e hundës?

Spërkatja e hundës përmban viruse që janë dobësuar për t'i parandaluar ata të shkaktojnë grip, por do t'ju ndihmojë të rrisni imunitetin.

Vaksina përthithet shpejt në hundë, kështu që edhe nëse teshtini menjëherë pasi keni marrë spërkatjen, nuk ka nevojë të shqetësoheni se nuk ka funksionuar.

A ka ndonjë efekt anësor të vaksinës?

Mund të keni rrjedhje ose bllokim të hundës, dhimbje koke, lodhje të përgjithshme dhe pak humbje oreksi. Megjithatë, këto janë shumë më pak të lehta sesa zhvillimi i gripit dhe ndërlikimet e tij. Efektet anësore të rënda janë të rralla.

Po sikur të mos ndihem mirë atë ditë?

Vaksinimi mund të vonohet nëse keni temperaturë. Gjithashtu, nëse keni hundë të bllokuara shumë ose rrjedhje, kjo mund të ndalojë hyrjen e vaksinës në sistemin tuaj. Në këtë rast, vaksinimi kundër gripit mund të shtyhet derisa simptomat e hundës të jenë pastruar.

Po ata të rinj që kanë një gjendje shëndetësore afatgjatë?

Nëse keni një gjendje shëndetësore afatgjatë që ju vë në rrezik më të lartë të komplikimeve të rënda nga gripi, duhet të bëni vaksinën e gripit çdo vit. Nëse keni një nga këto kushte shëndetësore dhe nuk jeni në një nga grupet që ju ofrohet vaksina kundër gripit në shkollë, mund t'i kërkonti gjithashtu klinikës së mjekut tuaj të përgjithshëm që t'ju japë vaksinën. Ju gjithashtu mund t'i kërkonti klinikës së mjekut tuaj të përgjithshëm që ta bëjë këtë nëse, për shembull, nuk dëshironi të prisni deri në seancën e vaksinimit në shkollë.

Kushtet shëndetësore afatgjata që ju rrezikojnë më shumë nga gripi

Këto kushte përfshijnë:

- probleme të rënda të mushkërive, të tilla si astma që ka nevojë për përdorim të rregullt të inhalatorit me steroide ose tabletave
- gjendje të rënda të zemrës
- sëmundje të veshkave ose të mëlçisë
- diabetit
- dobësimi i sistemit imunitar si rezultat i një gjendjeje ose trajtimi me ilaçe të tilla si tabletat steroide ose kimioterapia
- problemet me shpretkën, për shembull, sëmundja e qelizave drapër, ose shpretkë është hequr
- një paaftësi në të mësuar
- probleme me sistemin nervor, si paraliza cerebrale



Vizitoni www.nhs.uk/child-flu për më shumë informacione

A ka të rinj që nuk duhet ta bëjnë vaksinën me anë të hundës?

Shumicës së fëmijëve dhe të rinjve u ofrohet një vaksinë me spërkatje në hundë, e cila është e shpejtë dhe e lehtë për t'u administruar dhe është vakcina e preferuar për fëmijët. Megjithatë, disa të rinj mund të mos jenë në gjendje ta bëjnë vaksinën me spërkatje në hundë (shihni detajet më poshtë). Prindërve tuaj do t'u jepet një formular pëlqimi për ta plotësuar përpara vaksinimit, i cili do të përfshijë pyetje për të kontrolluar nëse vaksinimi është i përshtatshëm për ju. Ata mund të flasin me ekipin e imunizimit të shkollës nëse kanë ndonjë pyetje. Nëse nuk mund ta bëni spërkatjen në hundë, do t'ju ofrohet një vaksinë e injektueshme e gripit.

Kush nuk duhet ta bëjë vaksinën e hundës?

Në vend të vaksinës me spërkatje në hundë, duhet të bëni një vaksinë gripi të injektuar nëse:

- momentalisht keni vështirësi marrjeje fryme ose keni pasur frymëmarrje me zë gjatë 72 orëve të fundit
- keni një sistem imunitar shumë të dobësuar ose dikush në familjen tuaj ka nevojë për izolim sepse është me imunitet të dobët shumë
- keni një gjendje që kërkon trajtim me salicilate
- keni pasur një reaksion anafilaktik ndaj një vaksine gripi, ose ndonjë prej përbërësve, në të kaluarën (përveç vezës)

Të rinjtë që janë vaksinuar me spërkatje në hundë duhet të shmangin kontaktin e ngushtë me njerëz me sistem imunitar shumë të dobësuar (për shembull ata që sapo kanë bërë një transplant të palcës së kockës) për rreth dy javë pas vaksinimit.

Nëse kontakti është i mundshëm ose i pashmangshëm, atëherë duhet të jepet një vaksinë alternative kundër gripit. Nëse nuk jeni të sigurt, kontrolloni me ekipin e vaksinimeve të shkollës, ose me infermieren, ose mjekun e përgjithshëm në klinikën tuaj.

Prindërit tuaj duhet të kërkojnë këshillën e specialistit tuaj nëse keni:

- patur një reaksion të rëndë alergjik (anafilaksi) ndaj vezës në të kaluarën që kërkonte trajtim intensiv
- astmë që trajtohet me tableta steroide ose kërkon trajtim të kujdesit intensiv në spital.

Ku do të bëhet vaksinimi?

Fëmijëve në moshë shkollore do t'u ofrohet vaksinimi në shkollë, me mundësi të mëtejshme për t'u vaksinuar në klinikat e lagjeve, për këdo që mungon në seancën në shkollë.

Fëmijëve që ju takon dhe edukohen në shtëpi do t'u ofrohet vakcina. Ju ose prindërit tuaj mund të merrni informacion në lidhje me rregullimet nga Departamenti i Arsimit i Autoritetit tuaj Lokal.

Ju mund ta lexoni fletëpalosjen informuese të produktit të vaksinës këtu: www.medicines.org.uk/emc/product/15790/smpc

A përmban vaksina e hundës xhelatinë që rrjedh nga derrat (xhelatinë derri)?

Po. Vaksina me spërkatje në hundë përmban një sasi shumë të vogël xhelatine nga derrat (xhelatinë derri), e cila përdoret në një gamë të gjerë ilaçesh thelbësore. Xhelatina ndihmon që vaksina të jetë e qëndrueshme në mënyrë që ajo të funksionojë siç duhet.

Spërkatja nga hunda është vaksina e preferuar për fëmijët dhe është e shpejtë dhe e lehtë për t'u administruar. Mund të jetë gjithashtu më mirë në zvogëlimin e përhapjes së gripit në komunitet. Nëse nuk pranoni ilaçe ose vaksina që përmbajnë xhelatinë derri, është në dispozicion një injeksion vaksine kundër gripit që nuk përmban xhelatinë.

Ku mund të marr më shumë informacion?

Vizitoni www.nhs.uk/child-flu për më shumë informacion. Flisni me ekipin e imunizimit të shkollës, mjekun tuaj të përgjithshëm ose infermieren e klinikës nëse keni ndonjë pyetje të mëtejshme.



www.nhs.uk/vaccinations

© Crown copyright 2025. UK Health Security gateway number: 2024867. Product code: 25SECFLUAL Albanian. 1P 2M May 2025 (APS).

To order more copies of this leaflet please visit:

www.healthpublications.gov.uk or call 0300 123 1002.

That this leaflet is available in, Albanian, Arabic, Bengali, Bulgarian, Chinese (simplified), Chinese (traditional, Cantonese), Estonian, Farsi, French, Greek, Gujarati, Hindi, Latvian, Lithuanian, Nepali, Panjabi, Pashto, Polish, Portuguese, Romanian, Romany, Russian, Somali, Spanish, Tagalog, Turkish, Twi, Ukrainian, Urdu and Yiddish. Accessible versions are also available as an English large print, braille, British Sign Language video and audio version.